



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.29.06.2026, në ora 11:00, në Bibliotekën e Qytetit.

Të pranishëm ishin: Sami Ahmeti, Fjolla Nasufi, Albanë Shillova Shalaku, Vlora Mjekiqi Kabashi, Labinot Mirena, Abdyrrahman Krasniqi dhe Dorentina Krasniqi

Të pranishëm të tjerë: drejtorët komunal dhe përf, e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Sami Ahmeti, kryesues i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së (22.05.2026)
3. Shqyrtimi i Kornizës afatmesme të shpenzimeve për vitin 2027 dhe parashikimet për vitet 2028-2029
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës me nr.02-020/01-16835/26 të dt.12.06.2026 – Propozimvendimet e Kryetarit me nr.02-020/01-16814/25 dhe me nr.02-020/01-16811/26 të dt.12.06.2026 për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për parcelat kadastrale në Obiliq
5. Shqyrtimi i kërkesës së drejtorit të DSHPE-së me nr.06-104/02/15443/26 të dt.03.06.2026 për mbështetje financiare për përfundimin e objektit ndihmës pranë xhamisë në Raskovë
6. Shqyrtimi i kërkesës së kryesuesit të Komitetit për komunitete për shqyrtimin e planit të punës 2026 dhe raportin e punës për vitin 2025
7. Shqyrtimi i kërkesës së MSH-së, për anulimin e vendimit të KK me nr.01-060/01-11794/26 për organizimin për organizimin e kujdesit shëndetësor në Komunën e Obiliqit
8. Të ndryshme

Kryesuesi – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 7 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 7 vota për.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e Kornizës afatmesme të shpenzimeve për vitin 2027 dhe parashikimet për vitet 2028-2029.

Besnik Krasniqi – Unë nuk kam me shtue diçka, buxhetin e keni përpara dhe vetëm nëse, keni ndonjë pyetje mund ta bëni lirisht.

Fjolla Nasufi – E mbështesim këtë dokument të rëndësishëm për Komunën e Obiliqit dhe ia rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim dhe aprovim.

Vlora Mjekiqi Kabashi – Edhe ne jemi për atë që kjo pike e rendit të ditës ti rekomandohet Kuvendit Komunal për shqyrtim.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për i rekomanduan Kuvendit të Komunës shqyrtimin dhe aprovimin e Kornizës aftamesme të shpenzimeve për vitin 2027 dhe parashikimet për vitet 2028-2029.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës me nr.02-020/01-16835/26 të dt.12.06.2026 – Propozim vendimet e Kryetarit me nr.02-020/01-16814/25 dhe me nr.02-020/01-16811/26 të dt.12.06.2026 për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për parcelat kadastrale në Obiliq. Kryetaru sot nuk ka mund të marrë pjesë në mbledhje, por unë propozoj të ia rekomandojmë Kuvendit Komunal për shqyrtim dhe aprovim dhe në mbledhjen e Kuvendit mund të bëni pyetje dhe të kërkonit sqarime nga Kryetari dhe drejtori.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit të Komunës shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës me nr.02-020/01-16835/26 të dt.12.06.2026 – Propozim vendimet e Kryetarit me nr.02-020/01-16814/25 dhe me nr.02-020/01-16811/26 të dt.12.06.2026 për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për parcelat kadastrale në Obiliq.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së drejtorit të DSHPE-së me nr.06-104/02/15443/26 të dt.03.06.2026 për mbështetje financiare për përfundimin e objektit ndihmës pranë xhamisë në Raskovë. Kërkesës i mungon vija buxhetore nga e cila merren mjetet dhe e kisha lutë drejtorin e DEFZH-së, se a kemi mundësi me procedue mëtutje.

Besnik Krasniqi – Mjetet mund të merren nga kategoria subvencione dhe transfere.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit të Komunës shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së drejtorit të DSHPE-së me nr.06-104/02/15443/26 të dt.03.06.2026 për mbështetje financiare për përfundimin e objektit ndihmës pranë xhamisë në Raskovë.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së kryesuesit të Komitetit për komunitete për shqyrtimin e planit të punës për vitin 2026 dhe raportin e punës për vitin 2025. Materialin e kemi marrë dhe është një raport që mund të diskutohet por nuk votohet. Unë nuk e di përpara a kanë dërguar raport apo jo.

Vlora Mjekiqi Kabashi – Po e kanë dërguar, vitin e fundit e kanë dërguar.

Abdyrrahman Krasniqi - Është obligative Kryetari me i raportue Kuvendit, çdo 6 muaj realisht.

Kryesuesi – Po Kryetari gjithsesi, por e kemi raportin e kryesuesit të Komitetit për komunitete.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit të Komunës shqyrtimin e kërkesës së kryesuesit të Komitetit për komunitete për shqyrtimin e planit të punës për vitin 2026 dhe raportin e punës për vitin 2025.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së MSH-së, për anulimin e vendimit të KK me nr.01-060/01-11794/26 për organizimin e kujdesit shëndetësor në Komunën e Obiliqit.

Albertina Dedinca – Ne jemi në bisedime me Ministrinë e shëndetësisë dhe jemi duke i parë modalitetet se qysh duhet me bë dhe vetëm po na duhet mënyra e procedurave, iniciimi dhe kur e bëjmë këtë ndryshim bashkë me Komunën e Fushë Kosovës, ne do ta paraqesim në Kuvend.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 6 vota për dhe 1 votë abstenim ia rekomanduan Kuvendit të Komunës shfuqizimin e vendimit të KK me nr.01-060/01-11794/26 për organizimin e kujdesit shëndetësor në Komunën e Obiliqit.

Pika 8 e rendit të ditës

Kryesuesi – Ju njoftoj se nga drejtoresha e shëndetësisë kemi pranuar një kërkesë me dt.26 qershor e cila na informon se për shkak të përfundimit të përafërt të procedurave të fillimit të ndërtimit të QKMF-së re kërkon që të miratohet rrënimi i aneksit të QKMF-së.

Albertina Dedinca – Arsyeja e paraqitjes së kërkesës është se siç e dini Komuna e Obiliqit ka mbërri në fazën përmbyllëse të procedurave të Prokurimit për ndërtimin e rrjetit të ri të QKMF-së. Duke ditur se objekti ndihmës ekzistues ndodhet në vendin ku pritët të bëhet objekti i ri, është parakusht rrënimi i këtij objekti. Andaj, kërkoj nga Komiteti për Politikë dhe Financa, që ti rekomandoj Kuvendit Komunal për miratim rrënimin e këtij objekti.

Vlora Mjekiqi Kabashi - Unë sa jam në dijeni Kuvendi nuk merrë vendime për rrënim të objekteve, vetëm nëse i bartë ato ose janë dhënë më heret me vendime. Nëse, ju kujtohet çerdhja te Hashanët ne e kemi kthye parcelën në pronësi të Komunës dhe disa të tjera. Mirëpo, për rrënim që janë bërë vendimet i ka marrë Ekzekutivi. Ne nuk po e kundërshtojmë me dërgue në Kuvend, por mos po kthehet.

Kryesuesi – Ne i patëm 2,3 vendime në arkivin e Kuvendit që i gjetëm të paktën dhe njëra ishte rrënimi i objekteve të tregu, ishte vendim i Kuvendit dhe kishte marrë pëlqyeshmërinë e MAPL-së. Aty jemi bazuar pak sepse e pranojmë se as ne nuk e kemi ditë saktë si të veprohet megjithatë, nuk prish punë nëse e diskutojmë edhe nëse marrim vendim në fund të fundit na kthehet përgjegjja që nuk është punë e jona, por gjithsesi ju të informoheni çka saktë po duhet me u bë.

Abdyrrahman Krasniqi – Kryesues, po flas prej përvojës unë nuk besoj se ka nevojë Kuvendi me marrë vendim sepse ne si legjislativ e miratojmë buxhetin. Nëse, qeverisja don me realizue një projekt të ri të cilin edhe në fushatë e ka prolongue dhe e ka prezentue, e ka buxhetin prej Qeverisë nuk ka nevojë për asnjë pëlqim prej Kuvendit.

Kryesuesi - Unë propozoj ti rekomandohet Kuvendit, që të bisedohet për këtë temë, ndërsa drejtoreshën e lus që në mbledhjen e Kuvendit të vjen e përgatitur, ti merrë të gjitha informacionet aq të vlefshme prej personave që vërtetë kanë pasë përvojë në këtë drejtim.

Albertina Dedinca - Sqaron se kur i morëm lejet e rrënimin të secila leje për rrënim ishte me miratim të Kuvendit, me vendim të Kuvendit dhe vendimet për rrënim ishin krejtë me miratim të Kuvendit Komunal, kështu që e pashë të arsyeshme me sjellë në Kuvend nëse, veç e ka pasë praktikë të tillë edhe më heret.

Abdyrrahman Krasniqi - Ne e kemi rastin e Bibliotekës nëse, për shembull ato shtëpi që kanë qenë për me u shpronësue besoj se i kemi kalue përmes Kuvendit sepse kemi pasë obligim ligjor. Ne si Kuvend gjithsesi mund të votojmë, por unë qysh e di nuk kemi nevojë pse me tu kthye ty një shfuqizim kur ty nuk të pengon. Ajo është aset i Komunës, Kryetari realisht ka fitue, e ka prezentue këtë projekt dhe don me realizue, buxhetin e ka që është në rregullë.

Kryesuesi – Pajtohem plotësisht me juve dhe ky është arsyetimi më racional megjithatë, pse i rekomandojmë Kuvendit për miratim është se drejtoresha nesër mundet me tërheqë këtë pikë me thënë nuk kemi nevojë me shqyrtue fare.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit të Komunës shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së drejtores së DSHMS-së, për rrënimin e objektit ndihmës të QKMF-së në Obiliq.

Mbledhja përfundoi në ora 11:30'

Zyrtare e lartë për punë të KK

Azizë Zeneli



Kryesues i Komitetit

Sami Ahmeti